

**ASPEKTE HISTORIKE, POLITIKE, EKONOMIKE DHE
KISHTARE NË KOSOVË GJATË SHEKUJVE XI-XV TË
PËRMBLEDHURA NË NJË MONOGRAFI**

(Bedri Muhadri, *Kosova në mesjetë, shek. XI-XV*, Instituti i Historisë “Ali Hadri”-Prishtinë, 2021, 448 f.)

Në kuadër të veprimtarisë së tij botuese, Instituti i Historisë “Ali Hadri”-Prishtinë, gjatë vitit 2021 botoi monografinë *“Kosova në mesjetë, shek. XI-XV”*, të prof. asoc. dr. Bedri Muhadrit. Rezultatet shkencore që studiuesi Muhadri na i ofron në këtë monografi, i referohen segmenteve politike, etnike, ekonomike dhe kishtare, të përmbledhura në shtatë kapituj, duke përfshirë periudhën kohore shek. XI-XV.

Monografia *“Kosova në mesjetë, shek. XI-XV”*, fillon me problemet lidhur me popullsinë arbërore në Kosovë gjatë shek. XI-XV, ku trajtohen aspektet etnike-demografike në Kosovë gjatë atyre shekujve. Duke u mbështetur në burimet sllave si aktdhuratat e vitit 1330 dhe 1348, si dhe në Defterin e sanxhakut të Shkodrës nga viti 1485, Defterin e sanxhakut të Dukagjinit 1571 e 1591, si dhe Defterin e sanxhakut të Prizrenit 1591, autori na ofron të dhëna lidhur me aspektin etnik në Kosovë gjatë mesjetës sipas atyre burimeve, duke theksuar se mbi bazën e këtyre dokumenteve janë shfaqur studime të shumta, të cilat kanë vënë në dukje në mënyrë të qartë dhe të hollësishme praninë e popullsisë arbërore në Kosovë gjatë periudhës së sundimit serb.

Monografia në fjalë vazhdon me trajtimin e aspekteve historike e politike prej shek. XI deri në shek. XV, përkatësisht me problemet me të cilat u përballë Kosova, fillimisht si pasojë e pushtimit bullgar për të vazhduar më pastaj me pushtimin nga Zhupania e Rashës. Më tej, lidhur me këto probleme autori thekson se territori i Kosovës në dekadën e dytë të shek. XIII, u pushtua nga Dinastia e Nemanjidëve, e cila kishte arritur që të themelojë Zhupaninë mesjetare sllave të Rashës, që në kohën e Stefan Dushanit, 1331-1355, kishte arritur fuqinë më të madhe, kohë e cila përbën një nga periudhat më të vështira për popullsinë arbërore, ngase gjatë asaj kohe duke u mbështetur mbi bazën e ligjeve të njohura si “Zakoniku i Dushanit”, u ndërmorën disa veprime të rënda në të drejtën pronësore dhe

civile të qytetarëve, duke larguar nga ushtrimi i shërbimit fetar klerin vendës arbëror.

Në kuadër të kësaj monografie, në kapitullin e tretë autori i qaset edhe trajtimin të gjendjes kishtare në Kosovë gjatë shekujve XI-XV. Duke iu referuar burimeve historike, dëshmohet që në shek. XI, për veprimtarinë e Ipeshkvisë së Prizrenit dhe asaj të Lipjanit, të cilat ishin pjesë e Argjipeshkvisë së Ohrit, po ashtu dokumentet e kohës, dëshmojnë dhe tregojnë se kishat dhe manastiret ortodokse sllave u rindërtuan në territorin e sotëm të Kosovës gjatë shek. XIV. Lidhur me këtë, studiuesi Muhadri përmend disa raste si Kisha në Hvosne-Pejë, dhe Kishën e Apostujve të Shenjtë, si kishat e para të rindërtuara në Kosovë prej Nemanjidëve gjatë viteve 60-të të shek. XIII, pastaj Manastirin e Shën Stefanit apo të Banjskës të rindërtuar në themelet e manastirit të vjetër nga mbreti Milutin, nga viti 1312 deri më 1317, Manastirin e Shën Premtes (Shën Prendës), për të cilin autori thekson se në bazë të hulumtimeve arkeologjike, ky manastir është rindërtuar mbi themelet e kishës së vjetër e cila ka vepruar që nga koha e periudhës romake. Krahas këtyre çështjeve, në këtë kapitull ai trajton edhe famullit katolike në Kosovë dhe marrëdhëniet e tyre me Papatin.

Në monografinë *“Kosova në mesjetë, shek. XI-XV”*, një trajtim të gjerë autori u bënë edhe principatave arbërore, si asaj të Balshajve, Kastriotëve dhe Dukagjinëve, të cilat që nga gjysma e dytë e shekullit XIV dhe gjysma e parë e shekullit XV arritën të shtriheshin dhe të zotëronin disa krahina dhe qytete në Kosovë. Ko çështje dhe probleme tjera që ndërlidhen me rrethanat historike në Kosovë, në raport me principatat arbërore në fjalë, trajtohen në kapitullin e katërt, *“Kosova në rrjedhat historike nga vitet 70-të të shek. XIV deri në gjysmën e dytë të shek. XV”*.

Një temë mjaft e debatuar të cilës autori i qaset me përkushtim, është edhe Beteja e Kosovës e vitit 1389. Në kuadër të të dhënave për këtë betejë, autori fillon me trajtimin e rrethanave historike në Kosovë para kësaj beteje, për të vazhduar me trajtimin e burimeve historike si shqiptare ashtu edhe atyre osmane, si dhe për pjesëmarrjen e shqiptarëve në betejën në fjalë. Në vazhdim të të dhënave për Betejën e Kosovës, autori fokusohet edhe tek personaliteti i Millosh Kopilit, i cili konsiderohet si protagonist kryesor i kësaj ngjarjeje. Të gjitha këto janë të përmbledhura në kapitullin e pestë, *Beteja e Kosovës 1389 dhe rrjedhat historike e politike në Kosovë*.

Në kapitullin e gjashtë të monografisë *“Kosova në mesjetë, shek. XI-XV”*, trajtohet vendosja e pushtimit osman në Kosovë, të cilën autori e ka ndarë në dy faza. Faza e parë e pushtimit osman përfshinë vitet 1389-1427, ndërsa faza e dytë përfshinë vitet 1427-1453. Në kuadër të këtij periodizimi

autori ka trajtuar edhe çështje tjera që ndërlidhen me këtë, si Beteja e Dytë e Kosovës e vitit 1448, për t'u përqendruar tek burimet historike që i referohen kësaj beteje, si ato osmane, shqiptare, bizantine, sllave dhe raguzane. Krahas kësaj ngjarjeje historike, autori ndalet edhe tek dypushteti osman dhe serb në Kosovë gjatë viteve 1392-1455. Të gjitha këto të dhëna për Kosovën gjatë viteve 1389-1453, përmbillen me pushtimin definitiv të Kosovës nga Perandoria Osmane, si dhe me organizimin administrativ në Kosovë në gjysmën e dytë të shek. XV, pra pas rënies së Kosovës nën sundimin osman.

Kapitulli i shtatë dhe i fundit i kësaj monografie i kushtohet aspekteve ekonomike në Kosovë gjatë shekujve XIII-XV. Duke analizuar pozitën gjeografike si dhe pasuritë e mëdha xehetare të Kosovës gjatë mesjetës, autori konkludon se këta faktorë kanë ndikuar që territori i Kosovës gjatë shekujve XIII-XV të ketë qenë qendër e zhvillimeve ekonomike, zhvillime të cilat kanë ndikuar që në Kosovë të formohen qendrat e njohura të cilat u dalluan për zhvillimin e veprimtarive tregtare, si: Novobërda, Prizreni, Prishtina, Trepça, Peja. Gjithashtu në këtë kapitull autori prezanton edhe veprimtarinë e tregtarëve si shqiptarë ashtu edhe të huaj, që vepronin në qytetet e Kosovës, të cilët përveçse importonin produkte ekonomike, ata eksportonin edhe produkte të shumta nga Kosova, si drithërat: elb, li, mjaltë, dhe produkte xehetarie, si: plumb, zink dhe argjend të kualitetit të lartë.

Monografia "*Kosova në mesjetë, shek. XI-XV*", është e pasuruar edhe me aparaturë shkencore ngase përmban përfundimin, rezymenë në gjuhën angleze, treguesin e emrave, burimet si ato të pabotuara ashtu edhe ato të botuara, si dhe një literaturë të përzgjedhur. Për nga qasja dhe trajtimi i ngjarjeve që e karakterizuan Kosovën gjatë shekujve XI-XV, që studiuesi Bedri Muhadri i ka shtjelluar në monografinë *në fjalë*, mund të themi se botimi i saj paraqet një kontribut me vlerë për njohjen e zhvillimeve historiko-politike, ekonomike dhe kishtarë në Kosovë gjatë shekujve XI-XV.

Teuta SHALA-PELI

